

VENDIM
Nr. 626, datë 28.9.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 920, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË E SHITESA MBI PAGË DHE PËR PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FINANCIAR GJATË QËNDRIMIT NË PUNË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 80/2020, "Për Policinë e Burgjeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 920, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara me aktin normativ nr. 12, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, 'Për buxhetin e vitit 2022', të ndryshuar", në kuadër të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2022.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

PAGA BAZË MUJORE PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë
1	2	3
Bazë	Aspirant	53.500
	Nëninspektor	55.700
	Inspektor	58.400
	Kryeinspektor	64.000
I mesëm	Nënkomisar	70.000
	Komisar	77.000
	Kryekomisar	99.000
I lartë	Drejtues	115.000
	Drejtues i Lartë	125.000